

Piktura e artistit të njohur shqiptar Zef Shoshi pati tridhjetë vjet inkubacion. E realizuar në vitin 2024, e ushqen Fondacionin tonë me domethënie kuptimplota, për një vazhdimësi idealesh dhe frymëzimesh.

VIZIONI I ZEFIT

Gjatë dorëzimit të pikturës pranë Fondacionit ZKM, piktori u shpreh se kishte synuar ta krijonte këtë vepër që prej rënies së komunizmit në Shqipëri. Për këtë arsye është një testament shpirtëror. Historia dhe përkushtimi ndërthuren në telajo: ikona e Zojës së Këshillit të Mirë të Shkodrës, kështjella e Rozafës, ndërtesa e Shenjtërores së rindërtuar disa herë pas shkatërrimit të përsëritur ndër shekuj. Dhe pastaj njerëzit: gra dhe burra anonimë me kostume tradicionale, duke u lutur bashkë me fëmijët; autoritete të njohura fetare dhe civile të angazhuara në fushatëndryshmetekulturës dhe politikës shqiptare. Skena vendoset në një ditë të errët, gjatë ardhjes së mbrëmjes, si për të treguar një qëndrueshmëri shpirtërore kundrejt fatkeqësive me besimin se rilindja është në mbërritje, ndërsa mbetet e ancoruar me vlerat që mbështesin të renë. Skena dominohet nga besimi i njerëzve, i cili me forcën e tij tërheq në aktin e adhurimit edhe personat me autoritet që janë gjithashtu të pranishëm, të shfaqur në planin e dytë. **Personazhet e portretizuara në pikturë janë, nga qendra në të majtë: Imzot. Thaçi (Arqipeshkvi i Shkodrës), p. Anton Xanoni sj, p. Gjergj Fishta ofm, p. Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi (patriot), Zef Jubani (folklorist), Palok Kurti (kompozitor), Ndoc Xhuxha (aktivist politik).**

Zef Shoshi ka lindur në Tiranë në vitin 1939 dhe domosdoshmërisht jeta e tij artistike u formua dhe u zhvillua në kontekstin e regjimit komunist që dominoi Shqipërinë nga viti 1946 deri në vitin 1991. Pas katër vitesh studime në Shën Petersburg të Rusisë, Shoshi u diplomua në Akademinë e Arteve në Tiranë. Pikturat e tij kanë përfaqësuar jetën e njerëzve sipas parimeve të realizmit socialist. Kjo pikturë është një risi në prodhimin e tij artistik. Kompetenca në përdorimin e ngjyrave, aftësia për të kapur detajet e jetës së përditshme dhe aftësia e jashtëzakonshme për të pikturuar portrete kanë ngjallur shumë interes për veprën e Shoshit.



Zoja e Shkodrës, pikturë në vaj, Zef Shoshi



Udhëtim shpirtëror në Shkodër, 27 Prill 2024

Shumë të rinj italianë zgjedhën për të studiuar kampusin e Tiranës

STUDENTË ITALIANË NË ZKM



Edhe këtë vit, qindra studentë italianë po përfundojnë programet e studimit pranë ZKM. Kanë zgjedhur Kampusin tonë Universitar në kryeqytetin shqiptar, i cili është bërë shtëpia e tyre e dytë. Shqipëria është shumë afër Italisë dhe është një vend kandidat për anëtarësim në BE, i cili ofron kushte optimale për të studiuar dhe për të pasur një jetë sociale.. Kampusi, i vendosur shumë pranë qendrës së Tiranës u ofron studentëve italianë të gjithë hapësirën për nevojat e jetës së tyre të përditshme.

Në Universitetin Katolik është e mundur të merren tituj studimi që njihen plotësisht në Itali dhe në Bashkimin Evropian. Në këto njëzet vite të ZKM-së, kemi qenë një urë lidhëse midis Italisë dhe Shqipërisë për mijëra të rinj që kanë ardhur nga Italia dhe janë diplomuar këtu për mjekësi, arkitekturë, ekonomi, odontoiatri, infermieristikë, farmaci dhe fizioterapi.



Ne dhe Evropa

EVROPË, GJEJ SËRISH SHPIRTIN DHE PAQEN



Më datë 9 maj është Dita e Evropës dhe Kampusi gjallërohet për të festuar bashkërisht këtë event. E dashur Evropë, ti je një e vetme, por ndërkohë përqafon 27 vende me 450 milionë banorë në total të cilët kanë zgjedhur me vullnet të lirë të bashkohen për të formuar Bashkimin që ti je sot. Shqipëria është një vend kandidat dhe dëshirojmë ta shohim së shpejti në këtë Bashkim popujsh. Ndërkohë që prej njëzet vitesh Universiteti ZKM e ka sjellë Shqipërinë në Evropë dhe këtu në Tiranë mundësohet pajisja me diploma universitare me vlerë evropiane.



Turneu i basketbollit

UNICHAMPIONS


Më datë 8 maj, ekipi i basketbollit të UniZKM-së fitoi turneun ku merrnin pjesë 27 universitete shqiptare. Një rezultat i merituar për ekipin tonë sportiv, i cili kishte arritur në finale edhe në dy vitet e mëparshme. Të 12 sportistët me origjinë shqiptare dhe italiane kishin trajner udhëheqës shpirtëror Atë Paschal-in, nigerian, i vlerësuar si më i miri i turneut. Çmimi për lojtarin më të mirë e morri studenti Pasquale Maglioni. Ky ekip do të përfaqësojë Shqipërinë në aktivitetet e ardhshme sportive të basketbollit që do të zhvillohen në Evropë. Ky rezultat krijoi shumë entuziazëm në kampus, pas fitores së turneut e tenisit 2023.



UNAZA E MBRETIT SOLOMON



Sotir Qiriaqi është maratonisti që preu shiritin e inaugurimit të pistës së re të vrapimit në Kampusin e Fondacionit “Zoja e Këshillit të Mirë”, të quajtur “Unaza e Mbretit Solomon”. Sotiri është i njohur për shumë dashamirës të sportit pasi pavarësisht moshës së tij, me vullnet dhe përkushtim është kthyer në një model të jetës sportive të shëndetshme. Ai është dekoruar në vitin 2019 me Medaljen e Meritës së Klasit të Parë, duke e cilësuar si “Ambasador të Paqes”. Sotiri njihet nga të gjithë edhe si Ambasadori i Maratonës Shqiptare. Ai ka marrë pjesë në rreth 200 maratona të zhvilluara anembanë botës, duke dhënë shembullin e njeriut që frymëzon brezat e rinj nëpërmjet sportit. Për këtë arsye Sotiri u përzgjedh së bashku me Anisa Bakiun një tjetër maratoniste dhe studente e universitetit tonë, për të inauguruar pistën e vrapimit.



Harta e unazës

UKZKM është jo vetëm një institucion arsimor i nivelit ndërkombëtar, por edhe edukues e promovues i vlerave njerëzore. Pista e ka marrë emrin nga unaza e cila, sipas legjendës, është përdorur nga mbreti Solomon për të folur me kafshët. Në këtë mënyrë, Fondacioni ZKM ka dashur të kujtoj botën e kafshëve, shoqëruese e aventurës së njerëzimit në jetën në tokë, shtëpinë tonë të përbashkët.

Iniciativa verore e CESPIC në Universitet

SUMMER SCHOOL

Kemi kënaqësinë të njoftojmë se CESPIC po organizon edicionin Ke nëntë të Shkollës Verore. Si çdo vit, Shkolla jonë Verore “Roots of War & Establishment of a Lasting Peace” synon t’i ofrojë një grupi ndërkombëtar studentësh dhe të diplomuarish shtyllat shkencore mbi rrënjët e luftës, paqes dhe përvojat e ndërtimit të paqes.

Pedagogët e Shkollës Verore vijnë nga vende të ndryshme të botës, duke përfshirë Anglinë, Greqinë, Italinë, Turqinë, Norvegjinë dhe më gjerë, janë ekspertë në disiplinat e tyre dhe ofrojnë një gamë të gjerë këndvështrimesh. Leksionet zhvillohen ekskluzivisht në anglisht, duke siguruar një mjedis stimulues për shkëmbim kulturor dhe intelektual.

Regjistrimet janë të hapura!



Fondacioni ZKM ka nisur një proces lidhur me qëndrueshmërinë energjitike duke krijuar pranë Kompleksit universitar-spitalor të Tiranës një impiant fotovoltaik për prodhimin e energjisë elektrike.

ENERGJIA VJEN NGA QIELLI

Në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” u zhvillua Konferenca me temë “Energjia vjen nga qielli”, me rastin e Ditës së Tokës, që siç tha Presidenti i Fondacionit, Fr. Ruggero Valentini, është dita më e festuar në të gjithë globin. Konferenca u përshëndet nga z. Eduard Shalsi, Kryetar i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, Imzot. Gjergj Meta President i Konferencës Episkopale të Shqipërisë, prof. Giuseppe De Luca pedagog i Fakultetit, ark. Andia Guga nga Departamenti i Arkitekturës dhe arkitektët Alfons Shtjefni dhe Claudio Radice si dhe përgjegjësit e Shoqërisë Albesol.



Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë prodhon energji për Universitetin Katolik dhe për Spitalin nëpërmjet një impianti fotovoltaik të ndërtuar në Kampusin Universitar. Kjo është një përpjekje e rëndësishme ekonomike që ofrohet edhe si shembull për mbrojtjen e mjedisit, një iniciativë që u përgëzua edhe nga z. Eduard Shalsi në cilësinë e tij si përfaqësues i Parlamentit të Shqipërisë.


Në fjalën e tij Zoti Shalsi tregoi se autoritetet shqiptare inkurajojnë prodhimin e energjisë në mënyra të diversifikuara, duke rritur sipas tij efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e energjisë.

Imzot. Gjergj Meta tha gjatë reflektimit të tij se njeriu për shkak të egoizmit të tij vetëm ka përfutur nga natyra, duke e dëmtuar shpesh atë. Kështu që, sugjeroi se kemi për detyrë të mbrojmë shtëpinë tonë të përbashkët e cila është Toka, dhe që ka ardhur koha të përdorim kapacitetet tona në të mirë të planetit.



Në konferencë u shfaq dokumentari i titulluar “Letra”, i cili merr shkas nga mesazhi i Atit të Shenjtë “Laudato Si” i vitit 2015.

Personazh ZKM



AIDA AGOLLI

Klinika At Luigji Monti në qendër të Tiranës tek Rruga e Kavalës u përrua më 25 Prill 1995. Aida Agolli filloi bashkëpunimin me Fondacionin Zoja e Këshillit të Mirë në vitin 1997, duke kryer rolin e sekretares dhe recepcionistes së pacientëve fillimisht. Gjatë kësaj kohe aktiviteti i shërbimeve shëndetësore të klinikës është rritur, duke ruajtur gjithmonë karakteristikën e një shërbimi të gjerë dhe kompetent ndaj popullatës. Sot Aida mban rolin e drejtueses organizative të strukturës, duke konfirmuar përkushtimin e saj ndaj projektit bamirës të Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë.

Shërbime dedikuar shëndetit



FARMACIA IDIAL

Farmacia IDIAL filloi aktivitetin e saj në vitin 1995, si një kompani e krijuar ndërmjet “Idi Farmaceutici” s.p.a. dhe Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë. Ndodhet në Rrugën e Kavajës, 120, Tiranë, pranë Poliambulancës Atë Luigji Monti.

Një përvjetor i shumëpritur nga “bota ZKM” në festën patronale të Fondacionit

IL “CONSIGLIO” DI NOSTRA SIGNORA

Në fund të çdo muaji prill, në Kampusin tonë, kremtohet festa patronale e Zojës së Këshillit të Mirë, kushtuar Nënës së Jezusit dhe nderohet në Shenjtëroren e Shkodrës. Përhëndetjen dhe mirëseardhjen në këtë event e bëri Presidenti i Fondacionit, fr. Ruggero Valentini, i cili iu



drejtua studentëve, miqve, bashkëpunëtorëve, mjekëve dhe gjithë stafit të Spitalit Katolik. Pasditja u hap me kremtimin eukaristik nga Arqipeshkvi i Tiranë-Durrës Imzot Arjan Dodaj. Më pas, dhjetëra studentë sipas meritës morën bursa studimi bashkë




me urimet nga i gjithë stafi akademik i Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”. Pjesë e ceremonive ishte edhe inaugurimi i pistës së vrapimit “Unaza e Mbretit Solomon”, e cila përfaqëson një risi për strukturat universitare në Shqipëri. Nën tingujt më të mirë të muzikës bashkëkohore, pjesëmarrësit më pas u argëtuuan gjatë gjithë mbrëmjes.



KËRKUESIT TANË TË RINJ SHKENCORË



Emanuela Prendi



Florian Spada



Enkelelda Gjini

SESIONI I DIPLOIMIT



TAKIMET E ARDHSHEME...



LE CONSEGUENZE DEI CAMBIAMENTI CLIMATICI SUI MARI E SULLA SALUTE UMANA

23 Maggio
2024

09:00

Aula Magna
Università Cattolica NSBC, Tirana

Evento promosso dalla Fondazione "Nostra Signora del Buon Consiglio" nell'ambito del "Laudato Si" e organizzato dall'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio", in collaborazione con:

- Università degli Studi di Roma Tor Vergata
- Consorzio Nazionale Interuniversitario di Scienze del Mare (CoNISMa)
- Società Italiana di Biologia Marina (S.I.B.M.)
- Istituto Dermatologico dell'Immacolata, Roma
- IDI Farmaceutici, Pomezia

PROGRAMMA

LE CONSEGUENZE DEI CAMBIAMENTI CLIMATICI SUI MARI E SULLA SALUTE UMANA

9.00 Interventi di salute delle Autorità

9.30 RELAZIONI TEMATICHE, 1° SESSIONE

CAMBIAMENTI CLIMATICI E L'IMPATTO SU MARI E OCEANI

Prof. Giorgio Budillon

Prorettore per la Ricerca e i Rapporti Istituzionali,
Università degli Studi di Napoli "Parthenope"

L'IMPATTO DEI CAMBIAMENTI CLIMATICI SULLA PESCA E SULL'ACQUACOLTURA IN RELAZIONE ALLA SALUTE UMANA

Dott. Fabio Fiorentino

Dirigente di Ricerca, Consiglio Nazionale delle Ricerche, IRBIM

IL RISCALDAMENTO DEI MARI E IL RISCHIO D'INVASIONE DELLE SPECIE ALIENE

Dott.ssa Maria Cristina Gambi

Ricercatrice Associata all'Istituto di Oceanografia
e Geofisica Sperimentale di Trieste ed all'Istituto Superiore
per la Protezione e la Ricerca Ambientale, Roma

11.00 Pausa Caffè

11.30 RELAZIONI TEMATICHE, 2° SESSIONE

IL CASO OSTREOPSIS E L'IMPATTO SULLA SALUTE UMANA

Dott. Nicola Ungaro

Direttore dell'U.O.C. Ambienti Naturali, Centro Regionale Mare,
Agenzia Regionale per la Protezione dell'Ambiente, Regione Puglia

ONE HEALTH

Prof. Giovanni Rezza

Università Vita-Salute San Raffaele di Milano

GLI EFFETTI DEI CAMBIAMENTI CLIMATICI SULLA SALUTE DELLA PELLE

Prof. Sabatino Pallotta

Istituto Dermatologico dell'Immacolata (IDI), Roma

L'ADATTAMENTO DELL'INDUSTRIA FARMACEUTICA IN RELAZIONE AGLI EFFETTI PRODOTTI DAI CAMBIAMENTI CLIMATICI SULLA SALUTE DELLA PELLE

Dott. Luciano Ragni

Vicepresidente Esecutivo IDI Farmaceutici, Pomezia

COMITATO SCIENTIFICO & ORGANIZZATORE:

Prof. Angelo Tursi già Vicerettore dell'Università di Bari e Presidente
del Consorzio Nazionale Interuniversitario di Scienze del Mare (CoNISMa)

Prof. Michele Scardi Università degli Studi di Roma Tor Vergata e Vicepresidente della S.I.B.M.

Prof. Davide di Cave Università degli Studi di Roma Tor Vergata

Prof. Edmond Hajdéri Vicerettore dell'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio"



CONVEGNO

I VANTAGGI DEL LAVORO PER LE PERSONE SVANTAGGIATE: IL MODELLO ITALIANO DELLE COOPERATIVE SOCIALI DI TIPO B

17 maggio 2024

09:00

Aula Magna
Università Cattolica NSBC, Tirana



6TH HEALTH PROFESSIONS INTERNATIONAL CONFERENCE

NUOVE STRATEGIE PER AMPLIARE LA COLLABORAZIONE INTERNAZIONALE PER LA RICERCA INFERMIERISTICA E DELLE PROFESSIONI SANITARIE

31 maggio 2024

09:00

Aula Magna
Università Cattolica NSBC, Tirana